



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Anesi" Sh.P.K. të datës 25.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 20.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës në Institucionet Arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-1256-2-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 034 221, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Anesi" Sh.P.K. e datës 25.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 20.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës në Institucionet Arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-1256-2-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 034 221.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Anesi" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Anesi" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 25.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 20.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës në Institucionet Arsimore" me nr. të prokurimit 616-23-1256-2-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616 23 034 221.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit i referohen faktit që autoriteti kontraktues nuk është bindur me sqarimet që ka ofruar parashtruesi me datë 03.04.2023 lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktues B41 Letrën standarde mbi tenderin jo-normalisht të ulët të datës 30.03.2023. Me këtë rast bazuar në raportin e komisionit vlerësues të datës 14.04.2023 është evidentuar se komisioni vlerësues nuk është arritur të bindet me sqarimet e ofruara nga parashtruesi duke konstatuar se çmimi i ofertuar në këtë rast është jo-normalisht i ulët. Në anën tjetër parashtruesi e pretendon se ky çmim është në përputhje me tregun dhe nuk është jonormalisht i ultë sikurse ka konstatuar komisioni vlerësues. Njëkohësisht parashtruesi ka pretenduar se pikërisht çmimi i tenderuesit të rekomanduar për kontratë është çmim jonormalisht i ulët dhe për këtë arsye komisioni vlerësues nuk është dashur që të njëjtin të rekomandoj për kontratë.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 61 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”) si dhe nenin 41 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”).

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3 të RRPP, autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 04.05.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 22.03.2023.
- B54 Formulari standard për korrigjimin në njoftimet e publikuara të dt. 23.02.2023.
- Dosja e tenderit të dt. 23.02.2023.
- Përshkrimet e çmimit të dt. 06.03.2023.
- Oferta e parashtruesit.
- Procesverbali i hapjes së dt. 20.03.2023.
- B41 Letra standarde mbi tenderin jo-normalisht të ulët e dt. 30.03.2023.
- Përgjigja e parashtruesit në kërkesën për tenderin jonormalisht të ulët e dt. 03.04.2023.
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i dt. 14.04.2023.
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 20.04.2023.
- Letra standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 20.04.2023.

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit sipas nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të RRPP.

Fillimisht duhet sqaruar se pjesa e pretendimit të parashtruesit ku thotë se çmimi i ofruar nga tenderuesi i rekomanduar është jonormalisht i ulët, është në kundërthënie të plotë me pjesën tjetër të pretendimit ku ai konsideron se çmimi i ofruar nga vet ai nuk është jonormalisht i ulët. Kjo për arsye çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar është më i lartë se çmimi i ofertuar nga parashtruesi. Pra nuk ka mundësi që çmimi i tenderuesit të rekomanduar të jetë jonormalisht i ulët ndërsa çmimi i parashtruesit të mos jetë i tillë. Rrjedhimisht kjo pjesë e pretendimit është kundërthënëse, e paargumentuar dhe si e tillë tërësisht e pabazuar.

Sa i përket pjesës tjetër të pretendimit, ku parashtruesi konsideron se komisioni gabimisht ka gjetur se çmimi i ofertuar prej tij është jonormalisht i ulët, fillimisht duhet cekur se çështja e çmimit jonormalisht të ulët është e rregulluar me nenin 61 të LPP dhe me nenin 41 të RRPP. Përmes nenit 41 paragrafit 41.1 të RRPP përcaktohet se *“Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës”*.

Tutje përmes nenit 41 paragrafit 41.3 të RRPP përcaktohet se *“Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”*. Nga analizimi i ofertës së parashtruesit është gjetur se në këtë rast janë plotësuar të gjitha këto kritere dhe ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim.

Tutje përmes nenit 41 paragrafit 41.6 të RRPP përcaktohet se *“Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët”*. Bazuar në këtë dispozitë autoriteti kontraktues me datë 30.03.2023 ka dërguar te parashtruesi B41 Letrën standarde mbi tenderin jo-normalisht të ulët. As ky fakt nuk kontestohet fare nga parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim.

Tutje përmes nenit 41 paragrafit 41.8 të RRPP përcaktohet se *“Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara”*.

Njëkohësisht përmes nenit 41 paragrafit 41.9 përcaktohet gjithashtu se “Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet”. Parashtruesi në asnjë pjesë të kërkesës për rishqyrtim nuk ka arritur që të argumentoj ose të sqaroj se me cilat veprime apo për cilat arsye komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 41 paragrafit 41.8 dhe 41.9 të RRPP me rastin e shqyrtimit të përgjigjes së parashtruesit lidhur me kërkesën për sqarimin e tenderit jonormalisht të ulët. Me fjalë të tjera nuk është arritur të argumentohet që komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me këto dispozita sikurse pretendohet nga parashtruesi.

Tutje përmes nenit 41 paragrafit 41.10 të RRPP përcaktohet se “Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, “Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët”, brenda dy dite nga data e vendimit”. Në rastin konkret në raportin e komisioni vlerësues është evidentuar se sqarimi i ofruar nga parashtruesi nuk ka qenë i mjaftueshëm për komisionin vlerësues duke vepruar kështu në përputhje me nenin 41 paragrafin 41.10 nënparagrafin b të RRPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se komisioni vlerësues ka vepruar në përputhje me nenin 41 të RRPP. Njëkohësisht parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme apo dëshmi sipas të cilave do të dëshmohej e kundërta dhe do të mbështeteshin pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.05.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.